



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Ftesë për Ofertë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
Kredia Nr. 8211-AL

Titulli i Kontratës: ***Rehabilitimi i 5 skemave të ujitjes (vendndodhja në Lushnje, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)***

Lot 1: Skema ujitëse Murriz Thanë – Dega Krutje;
Skema ujitëse Murriz Thanë – Dega Terbuf;
Skema ujitëse Kurjan – Strum;
Skema ujitëse Koshnicë

Lot 2: Skema ujitëse Divjakë (Divjaka veri dhe Divjaka jug)

Nr. Referencës (sipas Planit të prokurimit): **MAFCP/W/ICB/004**

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një kredi nga Banka Botërore, kundrejt kostos së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, dhe ajo synon të aplikojë pjesë të këtij fondi kundrejt pagesës për Kontratën “Rehabilitimi i 5 skemave të ujitjes (me vendndodhje në bashkinë Lushnje, Divjakë, Roskovec, Devoll)”. Procesi i prokurimit do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Bankës Botërore.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) fton oferta të mbyllura nga ofertues të ligjshëm për rehabilitimin e 5 skemave të ujitjes (me vendndodhje në bashkinë Lushnje, Divjakë, Roskovec, Devoll). Numri dhe identifikimi i loteve (kontratave) që përbëjnë këtë procedurë prokurimi janë:

Lot 1 : Skema e ujitjes Murriz Thanë – Dega Krutje me zonë mbulimi 10,800 ha dhe gjatësi kanale kryesore dhe dytësore 145 km; Dega Terbuf me zonë mbulimi 4,180 ha dhe gjatësi kanale kryesore dhe dytësore 107 km.

Skema e ujitjes Kurjan-Strum - me zonë mbulimi 4,730 ha dhe gjatësi kanale kryesore dhe dytësore 88 km

Skema e ujitjes Koshnicë - me zonë mbulimi 350 ha dhe gjatësi kanali 20 km

Lot 2: *Skema e ujitjes Divjakë* – (Divjaka veri dhe Divjaka jug) me zone mbulimi 2,630 ha, 22 km tuba dhe 2 stacione pompimi. Punimet e rehabilitimit në skemen e ujitjes Divjaka jug mund të fillojnë me 6 muaj deri në 1 vit më vonë, në varësi të fillimit dhe zbatimit të punimeve për rehabilitimin e digës së Divjakës.

Skema e ujitjes	Përshkrimi i punimeve të kërkuara	Periudha e ndërtimit	Eksperiencë specifike
Lot 1 - Skema e ujitjes Murriz Thanë – Dega Krutje dhe dega Terbuf; Skema e ujitjes Kurjan-Strum; Skema e ujitjes Koshnice			Eksperiencë specifike në ndërtimin/rehabilitimin e punimeve në sistemet e ujitjes dhe kullimit
Skema e ujitjes Murriz Thanë – Dega Krutje dhe dega Terbuf	Rehabilitimi i kanalit kryesor dhe sekondar të veshur; Ndërtimi i veprave të kontrollit të niveleve; Veshja e seksioneve të perzgjedhura ne zonat me rrezikshmëri mesatare dhe të larte të rrëshqitjes së skarpatave; Ri-seksionimi i kanaleve të paveshur, kryesor dhe sekondar; Ndërtimi i strukturave të matjes së ujit.	8 muaj	Jo më pak se 10 kontrata secila me vlerë minimum 1 000 000 Euro (një milion Euro), por me vlerë totale të gjithë kontratave më të madhe se 10 000 000 Euro (dhjetë milion Euro)
Skema e ujitjes Kurjan – Strum			
Skema e ujitjes Koshnicë			
Lot 2 - Skema e ujitjes Divjakë			Eksperiencë specifike në ndërtimin/rehabilitimin e sistemeve me presion

<i>Skema e ujitjes Divjakë</i>	Ndertimi i nje stacionit të ri per pompimin per ngritjen e ujit nga kanali kryesor i kullimit te Terbufit per ne zonen Sulzotaj, Divjaka veri dhe jug. Furnizimi dhe shtrirja e linjes se tubacioneve HDPE ne keto zona. Ndertimi i nje stacionit të ri per pompimin per furnizimin e rezervuarit te Divjakes. Furnizimi dhe shtrirja e linjes sekondare me tubacione HDPE, per furnizimin e zones veriore dhe jugore te Divjakes. Furnizimi dhe shtrirja e linjes me tubacione HDPE, per marrjen e ujit nga Rezervuari i Divjakes per furnizimin e kanaleve te zones jugore te skemes se Divjakes. Ri-seksionimi i kanaleve të kullimit gjithe skemen e Divjakes. Ndërtimi i port-barazheve per dhe kontrollin e nivelit të ujit per gjithe skemen. Mbylljen e hapësirave ne Barazhin e Kripes dhe instalimi i tre portave të reja si dhe riparimi i portave ekzistuese.	8 muaj	Jo më pak se 4 kontrata secila me vlerë minimum 1 000 000 Euro (një milion Euro), por me vlerë totale të gjithë kontratave më të madhe se 4 000 000 Euro (katër milion Euro)
---------------------------------------	---	---------------	---

Konkurrimi do të zhvillohet sipas procedurave të Tenderit të Hapur Ndërkombëtar të përcaktuara në *Udhëzimet e Bankës Botërore: Prokurimi i Mallrave, Punimeve të Ndërtimit dhe Shërbimeve jo konsulencë nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA, botimi Janar 2011* (“Udhëzimet e Prokurimit”) dhe është i hapur për të gjithë konkurrentët nga vende të pranueshëm, sic përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit. Për më tepër referojuni paragrafeve 1.6 dhe 1.7 ku paraqiten politikat e Bankës mbi konfliktin e interesit.

Konkurrentët e ligjshme të interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), z. Ilirjan Lame, Menaxher Projekti, email: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al dhe të shikojnë dokumentat e tenderit gjatë orarit zyrtar nga ora 8.00 deri në 16.30 në adresën e dhënë më

poshtë: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Blv. Dëshmoret e Kombit, nr.2; Tiranë, Shqipëri. Dokumentat e tenderit mund të shikohen dhe në adresën www.bujqesia.gov.al

Një set i plotë i Dokumentit të Tenderit në gjuhën angleze mund të blihet nga konkurrentët e ligjshme të interesuar kundrejt paraqitjes së një kërkesë me shkrim në adresën më poshtë dhe kundrejt pagesës së pakthyeshme prej 5.000 Lekë. Metoda e pagesës do të jetë transfertë bankare në llogarinë bankare të mëposhtme

Mbajtësi i llogarisë: PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES, MBUMK
BLV DESHMORET E KOMBIT NR.2. 01101 TIRANE

BANKA CREDINS
SËIFT: CDISALTRXXX
Numri i llogarisë 00000558388
IBAN AL14212110160000000000558388

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën më poshtë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Blv. Dëshmoret e Kombit, nr.2; Tiranë, Shqipëri (zyra e protokollit) në ose para orës **12.00 datë 14 Tetor 2016**. Ofertimi elektronik nuk do të lejohet. Ofertat e vonuara nuk do të pranohen. Ofertat do të hapen publikisht në prezencë të përfaqësuesve të konkurrentëve dhe atyre që dëshirojnë të marrin pjesë personalisht në adresën më poshtë: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Blv. Dëshmoret e Kombit, nr.2; Tiranë, Shqipëri (kati i trete, salla e mbledhjeve) në orën **12.30 datë 14 Tetor 2016**.

Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me një “Sigurim oferte” në vlerën:

Lot 1: 255.000 Euro dhe Lot 2: 103.000 Euro

Sigurimi i ofertës, do të jete në formë garancie e pakushtezuar lëshuar nga një bankë.

Adresat që iu referuam më sipër janë:

Adresa e dorëzimit:

(Zyra e Protokollit) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Blv. Dëshmoret e Kombit, nr.2; Tiranë, Shqipëri.

Në vëmendje të z.Vojo Bregu

Kryetar i Autoritetit Kontraktor

Hapja Publike

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Blv. Dëshmoret e Kombit, nr.2; Tiranë, Shqipëri. (kati i tretë, salla e mbledhjeve)